

Informata për klientët përreth mbrojtjen e të dhënave personale



E nderuar kliente, i nderuar klient,

mbrojtja e të dhënave tuaja personale është shumë e rëndësishme për ne. Sipas rregullores së përgjithshme të Be-së për mbrojtjen e të dhënave personale, jemi te detyruar të ju informojmë për qëllimin për të cilin qendra jonë psikosociale mbledh, ruan dhe transferon të dhënat tuaja. Informacioni poashtu ju tregon, se qfarë të drejta keni ju përreth mbrojtjes e të dhënave personale.

1. Përgjegjësia e perpunimit e të dhënave

Përgjegjesi për perpunimin e të dhënave:	Zyrtari përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave:
St. Johannis GmbH /PSZ	Christian Günther
Dr. John-Rittmeister-Straße 6	Dr. John-Rittmeister-Straße 6, 06406 Bernburg
06406 Bernburg	Email: datenschutz@stejh.de
Email: kontakt@psz-sachsen-anhalt.de	Telefon: 03471/3009964

2. Qëllimi i perpunimit e të dhënave

Përpunimi i të dhënave kryhet për ti plotësuar të gjitha kërkesat ligjore që janë të parapara në kontratë dhe poashtu detyrimet tjera që janë në lidhje me tajtimin mes jush dhe psikologut tuaj, psikoterapisit, mjekut ose ndonjë punonjësit tjetër.

Për këtë arsye ne përpunojm të dhënat tuaja personale, në veçanti të dhënat tuaja shëndetësore. Këto përfshijnë historitë mjeksosre, diagnozat, sugjerimet terapeutike dhe të dhënat tjera tuaja që ne poashtu i mbledhim.

Kërkesa e të dhënave tuaja personale është e domosdoshme për trajtimin tuaj. Nëse neve nuk na ofrohen të gjitha informacionet e nevojshme, ne nuk mund të sigurojm një trajtim të kujdesshem dhe të plotë për ju.

Gjithashtu është e mundur që për aspekte të terapisë ose këshillim psikosocial të kërkohen nga ju të dhëna përreth prejardhjes tuaj etnike, opinionit politik, besimit fetar ose orientimit tuaj seksual, vetëm nëse këto janë të domosdoshme për një trajtim dhe këshillim tuaj të mëtutjeshëm.

3. Përdoruesitë e të dhënave tuaja

Ne i transferojm të dhënat tuaja personale në palen e tretë vetëm atëherë nëse ju e keni pranuar këtë dhe nëse kjo është poashtu e lejuar nga ligji. Marrësit e të dhënave tuaja personale, në veçanti atyre shëndetësore mund të jenë kompani të sigurimeve shëndetësore, shërbime të sigurimit mjeksor dhe poashtu zyret te sigurimeve shoqërore.

Bartja e të dhënave kryhet kryesisht për qëllimin e llogaritjeve të arritjeve tuaja ose për sqarimin e pyetjeve shëndetësore dhe atyre në lidhje me sigurime tuaja. Transferimi i të dhënave tek personat autorizuar si për shembull tek avokati juaj është e mundur vetëm atëherë nëse ju e keni nënshkruar këtë në deklaratë perkatëse.

4. Ruajtja e të dhënave tuaja

Për shkak të kërkesave ligjore ne jemi të detyruar ti ruajm të dhënat tuaja të raporteve të trajtimit të pakten 10 vite më pas. Në raste speciale si për shembull (Fotografitë me rreze) edhe 30 vite më pas.

5. Të drejtat tuaja

Ju keni të drejtë të merrni informacione përreth të dhënave personale që lidhen me ju. Ju gjithashtu mund të kërkontë korrigjimin e të dhënave të pasakta.

Përveq kësaj, në kushte të caktuara, ju keni të drejtë ti fshini të dhënat, ta kufizoni përpunimin e tyre dhe keni të drejtën për transportueshmërin e tyre.

Nëse përpunimi i të dhënave tuaja është i lejuar nga ju, ju keni poashtu të drejtë në çdo kohë ta rekovoni (tërheqni) këtë. Ky revokim nuk ka ndikim në ligjshmërinë e lejimit të përpunimit e të dhënave deri në momentin e revokimit (tëreqjes) së tyre. Ju lutemi të vini re se në këtë rast mund të mos jetë e mundur të perpunohen të dhënat në të ardhmen.

Ju keni gjithashtu të drejtë të ankohuni tek autoriteti mbikqyrës për mbrojtjen e të dhënave personale nëse jeni të mendimit se përpunimi i tyre nuk është i drejtë.

Adresa e autoritetit mbikqyrës për ne është:

Emri: Landesbeauftragter für den Datenschutz Sachsen-Anhalt

Adresa: Postfach 1947, 39009 Magdeburg

6. Bazat ligjore

Përveq deklaratës së pëlqimit, më poshtë është poashtu baza ligjore për përpunimin e të dhënave tuaja, neni 9, Paragrafi 2 h) në rregulloren e përgjithshme të BE-së në lidhje me paragrafin 22 Nr. 1 b) në aktin federal për mbrojtjen e të dhënave. Nëse keni ndonjë pyetje ju mund të na kontaktoni çdokohë.

DEKLARATË PËLQIMI

Unë i kam lexuar dhe kuptuar të dhënat e mësipërme.

Unë (Emri) _____ pranoj që të dhënat e mia personale, si prejardhja ime, pikëpamjet politike, besimi fetar, të dhënat shëndetsore dhe orientimi seksual mund të përpunohen nëse ato përdoren për arsye të regjistrimit, këshillimit apo janë të nevojshme për këshillime tjera të mëtutjeshme. Vlerësimi i nevojës kryhet nga stafi i specializuar personal i Qendres Psikosociale.

Pëlqimi është vullnetar dhe mund të revokohet (tërhiqet) në çdo kohë në të ardhmen.

NËNSHKRIMI